



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

RAPORTI VJETOR I PUNËS

2018



Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së

Të nderuar lexues,

Është kënaqësia ime që në kuadër të transparencës me publikun t'ju prezantoj Raportin Vjetor të Punës së SHÇBA për vitin 2018. Gjatë vitit që lamë pas, Shërbimi ka vijuar përpjekjet në përmbushje të misionit të tij për garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.

Në kuadër të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 70/2014 për *“Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”*, gjatë vitit 2018 është punuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së Shërbimit, në funksion të mbikqyrjes dhe kontrollit të punës së strukturave, objekt i veprimtarisë së tij.

Në këtë raport pasqyrohen treguesit kryesorë të veprimtarive të strukturave kyçe të Shërbimit, të arritura gjatë vitit 2018, si në aspektin e hetimit administrative të ankesave dhe inspektimeve ashtu edhe në hetim penal të shkeljeve të ligjit, nga punonjës të strukturave. Pasqyrohet angazhimi ndërinstitucional i Shërbimit, përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat strategjike ndërinstitucionale dhe planeve konkrete të veprimit, në kuadër të proceseve integruese të vendit tona në Bashkimin Europian. Gjen pasqyrim veprimtaria e strukturave të shërbimeve mbështetëse dhe sektorit të financës së Shërbimit ashtu si dhe prioritetet, objektivat dhe synimet tona për vitin 2019 e në vazhdim.

Vizioni ynë është shndërrimi i Shërbimit në një agjenci ligjzbatuese efektive që mbështetet në inovacionin teknologjik, angazhimin proaktiv në luftën kundër fenomeneve negative që prekin strukturat subjekt i veprimtarisë, si edhe në integritetin dhe profesionalizmin e shfaqur nga specialistët tanë, në çdo etapë të hetimeve të kryera.

Për realizimin me sukses të këtij vizioni madhor, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ka hartuar një program të qartë veprimesh për vitin 2019. Në kuadër të këtij programi janë përcaktuar edhe prioritetet dhe objektivat përkatëse, të cilat do të udhëheqin dhe orientojnë punën në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektit të veprimtarisë.

Përafrimi i legjislacionit dhe organizimit të SHÇBA-së me atë të vendeve të BE-së është një nga synimet kryesore të Stafit të ri drejtues, gjë e cila vjen si rrjedhojë për shkak të interferencave që vijnë nga faktorë të rëndësishëm si Paketa e Reformës në Drejtësi, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë, etj. Ekzistenca e këtyre faktorëve e kanë lënë prapa bazën ligjore të Shërbimit dhe këta faktorë nuk janë pasqyruar në të.

Për të ardhmen synohet shtrirja e bashkëpunimit me strukturat homologe të Shërbimeve për Çështjet e Brendshme, kryesisht me vendet e BE-së, për të njohur dhe përfituar nga arritjet e tyre në drejtim të organizimit strukturor e funksional si dhe standardeve të arritura.

Intesifikimi i punës sensibilizuese të publikut për denoncimin e shkeljeve të ligjit nga punonjësit e strukturave, nëpërmjet fushatave promovuese dhe transparencës përmes publikimit të treguesve dhe rezultateve të arritura nga hetimet administrative të ankesave në mënyrë periodike, është një tjetër objektivi i Shërbimit për vitin 2019.

Në emër të stafit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, falenderoj publikun për mbështetjen që kanë dhënë për përmbushjen e misionit tonë, përmes bashkëveprimit dhe mbikqyrjes së jashtme qytetare në funksion të zbatimit të ligjit nga strukturat e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe shërbimit Zjarrfikës.

Shpresoj që ky Raport të ndihmojë në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit Shërbim – publik, përmes informimit dhe transparencës me qytetarët.

Muhamet Rrumbullaku
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PASQYRA E LËNDËS

Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHÇBA-së.....	1
Përmbledhje mbi Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat	4
Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave	5
Spektori i Inspektimit të Ankesave	5
Spektori i Inspektimit të Përgjithshëm.....	9
Veprimtaria e Drejtorisë së Hetimit	10
Veprimtaria e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse	12
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	12
Spektori i Financës.....	13
Angazhimi ndërinstitucional i SHÇBA-së.....	14
Vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë	14
Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat strategjike ndërinstitucional dhe planeve konkrete të veprimit.....	15
Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.....	15
Prioritetet dhe objektivat e SHÇBA-së për vitin 2019.....	16
Si mund të na kontaktoni	19

Hyrje

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme operon dhe ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit organik Nr. 70/2014 dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij.

Fusha e zbatimit

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat e ushtron veprimtarinë e tij ndaj strukturave të:

- a. strukturave të Policisë së Shtetit;
- b. strukturës përgjegjëse për ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve të rëndësishme të veçantë;
- c. strukturës së Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin.

Objekti i veprimtarisë

- a. parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;
- b. inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit;
- c. ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;
- d. verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
- e. analiza, studime dhe rekomandime të përgjithësuara në bazë të inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e të funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.

Në organizimin e brendshëm të tij, Shërbimi operon sipas 6 shtyllave kryesore, që përbëjnë dhe veprimtarinë e sëj, që janë;

- Veprimtaria informativo-gjurmuese
- Veprimtaria hetimore procedurale penale
- Veprimtaria hetimore administrative
- Veprimtaria Inspektuese
- Veprimtaria e vlerësimit dhe shqyrtimit të Ankesave.
- Veprimtaria e Vettingut dhe Monitorimit të Brendshëm

Ligji organik përcakton një organizim të centralizuar të Shërbimit me dy nivele, në nivelin qendror dhe nivelin vendor të strukturave të tij. Kështu gjatë vitit 2018, u hartuar dhe miratua një strukturë dhe përbërje e re organike e Shërbimit, e cila ka sjellë një formë të re organizimi të strukturave të Shërbimit në nivel vendor, me krijimin e Drejtorive Rajonale të Shërbimit.


I. Treguesit e punës së arritur nga strukturat e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

❖ Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajtimit të Ankesave

Gjatë vitit 2018, veprimtaria e Sektorit të Inspektimit të Ankesave, në Drejtorinë e Inspektimit dhe Trajtimit të Ankesave të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, reflektohet në treguesit, e mëposhtëm, vijon:

- Telefonata të publikut në Linjën e Gjelbër – **5940** telefonata
- Ankesa të marra në nivel qendror dhe vendor – **1978** ankesa


Trendi i ankesave dhe telefonatave të pranuar në SHCBA



Nga paraqitja grafike vihet re një rritje e numrit të ankesave të adresuara nga publiku pranë Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, ndaj sjelljeve jo etike e deri tek shkeljet e ligjit nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit.


Nga analizimi i ankesave të pranuar nga strukturat vendore dhe qendrore, pas administrimit, vlerësimit dhe analizimit të tyre, kemi këtë paraqitje grafike mbi trendin e ankesave sipas strukturave dhe llojit të shkeljes së dyshuar, e konkretisht:

Trendi i ankesave në bazë të strukturave




Nga të dhënat e pasqyruara në grafik, evidentohet se struktura për të cilën janë adresuar më shumë ankesa nga publiku pranë Shërbimit, vijon të mbetet Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, pasur nga DVP-të Durrës, Vlorë, Korçë, Shkodër e Elbasan, ndërsa ndër strukturat rajonale të Policisë Kufitare rezulton DVKM Durrës e pasuar nga DVKM Korçë e Shkodër. Kjo renditje, sa i përket strukturave të Policive Vendore, lidhet me faktin se në këto qarqe kemi numrin më të madh të përqëndrimit të popullësisë së vendit, dinamika e jetës është tepër aktive si dhe problematikat e hasura nga Policia e Shtetit janë më të shumta në numër dhe në shumëllojshmëri. Varësisht këtyre elementëve edhe propabiliteti i “përplasjeve” e “pakënaqësive” të publikut apo dhe “mundësisë së abuzimit” nga punonjësit e këtyre strukturave të jetë më i lartë.

Trendi i ankesave sipas objektit



Sipas treguesve statistikor të paraqitur në këtë grafik rezulton se trendi i shkeljeve të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, të adresuara nëpërmjet denoncimeve të publikut pranë SHÇBA-së, mbizotërohet nga:


- “mosveprim” – me **571 ankesa**
- “shkelje të procedurave standarde të punës” – me **246 ankesa**
- “veprime arbitrare” – me **220 ankesa**
- “gjobe e padrejtë” – me **199 ankesa**
- “shkelje të normave të etikës” – me **138 ankesa**



Ky trend rezulton të jetë pothuajse në të njejtat vlera, me përjashtim të shkeljes “mosveprim” që ka pësuar një rritje sinjifikative, kjo edhe për shkak të natyrës së këtyre ankesave, pasi kanë të bëjnë kryesisht me zgjidhje konfliktesh të natyrave të ndryshme, të zakonshme në jetën komunitare.

Nga trajtimi i ankesave në tërësi gjatë periudhës analizuese, ka rezultuar se;

- Në **9 raste**, nga **6 punonjës policie janë gjetur shkelje ku janë konstatuar elementë të veprës penale**, duke bërë referimin e materialeve pranë organit të Prokurorisë, për punonjësën objekt të ankimimit.
- Në **125 raste**, nga **229 punonjës policie janë gjetur shkelje të karakterit administrativ**, duke sugjeruar fillimin e hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, për punonjësën objekt ankimimi;
- Në rastet e tjera, veprimet e punonjësve kanë qenë konform rregullave dhe Procedurave Standarde të Punës.



Gjatë vitit 2018, veprimtaria e **Sektorit të Inspektimit të Përgjithshëm**, në Drejtorinë e Inspektimit dhe trajtimit të Ankesave, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e këtij sektori dhe Planit Vjetor të Inspektimeve¹, reflektohet në këta tregues, si më poshtë vijon:

Janë kryer gjithsej **34 inspektime** nga këto:


- **5 Inspektime** të planifikuara
- **11 Inspektime** të paplanifikuara
- **18 Inspektim** për trajtim ankesash

¹ Miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 306, dat 05.02.2018

Në përfundim të inspektimeve

- Janë evidentuar gjithsej **52 konkluzione**
- Janë dhënë gjithsej **73 rekomandime**
- Është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **555 punonjës**
- Janë referuar materialet për fillimin e procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Shkodër dhe Elbasan, për **5 punonjës**

Tabelë krahasimore 2017 - 2018




❖ **Veprimtaria e Drejtorisë së Hetimit** (në nivel qendror dhe vendor)

Në funksion të hetimit penal, nga strukturat vendore dhe qendrore të Shërbimit, për vitin **2018** janë dërguar pranë organit të Prokurorisë materialet referuese ndaj punonjësve të strukturave që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale, e konkretisht:

Gjatë vitit **2018** janë referuar në prokurori:

- **201** referime penale për
- **265 persona**, nga të cilët:
 - **52** punonjës policie të nivelit të parë drejtues,
 - **178** punonjës policie të nivelit zbatues,
 - **5** punonjës administrative,
 - **7** punonjës të Gardës së Republikës
 - **5** punonjës i PMNZSH dhe
 - **18** shtetas.


Arrestuar në flagrancë/ndaluar **53** persona, nga të cilët **4** punonjës policie të nivelit të parë drejtues, **39** punonjës policie niveli zbatues, **3** efektive të Gardës dhe **7** shtetas.



Edhe për vitin 2018 trendi i veprave penale vazhdon të jetë i njëjtë, e konkretisht:

- **100** referime penale për veprime korruptive,
- **9** referime penale për veprime që lidhen me favorizimin/implikimin në trafikë
- **58** referime penale për kryerjen e veprimeve arbitrare
- **16** referime penale për shkelje të kodit rrugor
- **18** referime penale për vepra të tjera penale

Tabele krahasimore



❖ Veprimtaria e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektorit të Financës

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është njësi përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, dhe teknike të Shërbimit, me qëllim forcimin e kapaciteteve organizative dhe administrative të Shërbimit.

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave që ligji dhe rregullorja përcaktojnë për këtë drejtori, gjatë vitit 2018, veprimtaria e saj konstaton në:

– Rekrutimet, emërimet, transferimet, lirimet nga detyra

Gjatë vitit u bënë:

- **3** procedura konkurimi për pranime të reja në Shërbim, me:
 - **16** kandidatë pjesmarrës, nga të cilët:
 - **13** kandidatë fitues,
 - **4** prej të cilëve u emëruan në pozicionet vakante.

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të kryerjes së detyrave, për nevojat e punës së vetë Shërbimit, gjatë vitit janë kryer **9 transferime** nga një sektor në një sektor tjetër.

Ndërsa në kuadër të implementimit të Strukturës dhe Përbërjes së re Organike të Shërbimit², janë konfirmuar sipas kësaj strukture në funksionet e punës **46 punonjës me gradë dhe pa gradë** të Shërbimit dhe **1 punonjës me kontratë**.

Janë larguar nga strukturat e Shërbimit **11 punonjës**, nga të cilët:

- **2 punonjës** kanë dalë në reformë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 12/2018³;
- **5 punonjës** janë larguar me motivacionin “*Me kërkesën e tij*”;
- **1 punonjës** është larguar me motivacionin “*mos konfirmim në detyrë*”;
- **1 punonjës** është larguar me motivacionin “*për dekonspirim*”;
- **1 punonjës** është larguar me motivacionin “*për shkak të daljes në pension pleqërie*”;
- **1 punonjës** me motivacionin “*kërkesë për pezullim të statusit të nëpunësit civil*”.

– Edukimi, trajnimi i personelit

Gjatë vitit 2018 u zhvilluan **5 trajnime** ku morën pjesë **38 punonjës**, nga të cilët:

- **32 punonjës** të Shërbimit nga personeli pa gradë morën pjesë në “*Kursin bazë për hetimen e krimeve*”, organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë (Fakulteti i Hetimit) dhe ICITAP, në periudhat 3 – 13 Prill e 16 – 25 Prill 2018.
- **4 punonjës** të Shërbimit kanë qenë pjesë e trajnimeve për “*Ngritjen në Gradë*” organizuar në Akademinë e Sigurisë. Nga të cilët **2 punonjës** për gradën “*Drejtues i Shërbimit*” dhe **2 punonjës** për gradën “*Inspektor i Parë*”.

² Urdhri i Ministrisë të Brendshme nr. 579, datë 26.10.2018 “*Për miratimin e Strukturës dhe Përbërjes Organike të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme*”.

³ Ligji nr. 12/2018 “*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme*”.

- **1** punonjës i Shërbimit ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Akademia e Policisë Zagreb, në datat 7 – 11 Maj 2018 me temë “*Teknikat e Vëzhgimit*”.
- **1** punonjës i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga ASPA më datat 11 – 12 Qershor 2018 me temë “*Konflikti i interesit*”.
- **Masa disiplinore**

Gjatë vitit 2018, janë dhënë **7** masa disiplinore të lehta dhe **1** masë disiplinore e rëndë për punonjës të Shërbimit, e konkretisht:

- për **3 punonjës** është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje*”
- për **4 punonjës** është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”
- për **1 punonjës** është dhënë masa disiplinore “*Shtyrje e afatit të gradimit edhe për 12 muaj*”

Sektori i Buxhet-Financës

Objektivat e Sektorit të Buxhet – Financës hartohen në funksion të zbatimit të objektivave të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Për vitin 2018, Shërbimit si njësi buxhetore brenda Ministrisë së Brendshme, i janë akorduar fonde buxhetore në shumën prej 197,836,200 lekë, bazuar kjo në kërkesat tona të paraqitura gjatë fazës së PBA (prill – gusht 2017). Ky fond është realizuar në shumën prej 189,785,586 lekë ose në masën 96%.

Më poshtë pasqyra përmbledhëse e realizimit të shpenzimeve buxhetore

(në lekë)

<i>Nr.</i>	<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real. në %</i>
<i>1</i>	<i>600</i>	<i>Paga & shpenz. personeli</i>	<i>117,100,000</i>	<i>117,051,977</i>	<i>48,023</i>	<i>100%</i>
<i>2</i>	<i>601</i>	<i>Sigurime shoqerore</i>	<i>20,900,000</i>	<i>19,300,260</i>	<i>1,599,740</i>	<i>92%</i>
<i>3</i>	<i>602</i>	<i>Mallra e shërbime të tjera</i>	<i>26,000,000</i>	<i>20,597,593</i>	<i>5,402,407</i>	<i>79%</i>
<i>4</i>	<i>606</i>	<i>Transf.buxhetet familjare</i>	<i>3,216,700</i>	<i>2,526,204</i>	<i>690,496</i>	<i>79%</i>
<i>5</i>	<i>231</i>	<i>Investime</i>	<i>30,619,500</i>	<i>30,309,552</i>	<i>309,948</i>	<i>99%</i>
<i>TOTALI</i>			<i>197,836,200</i>	<i>189,785,586</i>	<i>8,050,614</i>	<i>96%</i>

II. Angazhimet ndërinstitucionale të SHÇBA dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin prej tyre

❖ Vettingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Në kuadër të përcaktimeve dhe detyrimeve ligjore të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, edhe gjatë vitit 2018 Shërbimi është përfaqësuar me një anëtar në Grupin e Punës⁴, në DSIK dhe angazhuar në kryerjen e procedurave verifikuese për një nga tre shtyllat e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, atë të kontrollit të figurës.

Ky proces, përveç përfaqësimit dhe angazhimit në Grupin e Punës, është konkretizuar edhe në kryerjen e procedurave verifikuese, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, mbi bazën e kërkesave për informacione shtesë mbi subjektet e rivlerësimit apo “*personave të lidhur/të tjerë të lidhur*”⁵ të evidentuara gjatë hetimit administrimit të inicuar nga KPK për këto subjekte rivlerësimi. Kështu gjatë vitit 2018 janë përcjellë nga GP/DSIK në SHÇBA **65 praktika të tilla**, adresuar nga ana jonë për strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe **65 praktika kthim** përgjigje për GP/DSIK, duke respektuar afatet ligjore të verifikimit.

Bashkëpunimi ndërinstitucional SHÇBA-DSIK në kuadër të këtij procesi është vlerësuar me nota pozitive nga palët⁶ e përfshira në këtë proces të rëndësishëm për vendin tonë.

❖ Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentat strategjike ndërinstitucionale dhe planeve konkrete të veprimit

Gjatë vitit 2018, është organizuar dhe ndjekur puna në raportimin periodike për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjitë Kombëtare dhe Planeve Konkrete të Veprimit, në funksion të misionit dhe objektivit të veprimtarisë së Shërbimit, konkretisht:

- Raportimet periodike⁷ në lidhje me “*Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2020*”⁸ dhe “*Planit të Veprimit 2018 – 2020*”⁹, pranë Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit.
- Përfaqësim në nivel drejtuesi në Task Forcën Qendrore për ndjekjen e zbatimit të këtij plani dhe raportimet periodike për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të “*Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017 – 2020*”¹⁰, tek Sekretariati Teknik, Ministria e Brendshme.

⁴ Urdhri nr. 1163, datë 28.07.2017 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit dhe Urdhrit të Përbashkët të Titullarëve të SHISH, SHÇBA dhe DSIK, nr. 2121, datë 03.08.2017.

⁵ Pikat 13 e 14 të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, DSIK e Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit

⁷ Raportimet periodike përfshijnë periudhat 1-mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe 12 –mujore të raportimit

⁸ V.K.M nr. 247, datë 20.03.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015 – 2020”.

⁹ V.K.M nr. 241, datë 20.04.2018 “Për miratimin e Planit të Veprimit 2018 – 2020”.

¹⁰ VKM nr. 248, datë 29.03.2017 “Për miratimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017 – 2020”

❖ **Përmbushja e misionit, objektit të veprimtarisë së Shërbimit, në funksion të proceseve integruese të Shqipërisë në BE**

Edhe gjatë vitit 2018, SHÇBA ka qenë pjesë e angazhimeve dhe përpjekjeve të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë Shqiptarë në funksion të proceseve integruese¹¹ të Shqipërisë në Bashkim Europian, konkretisht:

- Raportimet periodike dhe pjesmarrje në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Europian (GNPIE) për Kapitujt *“Kriteri Politik”* dhe *“Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”*, ku institucion lider është Ministria e Drejtësisë.
- Raportimi për takimin e *10-të të Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë* zhvilluar këtë vit në Tiranë, në datat 12 - 13 Korrik 2018.
- Raportimin për takimin e *9-të Komitetit të Stabilizim – Asociimit*, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Bashkimi Europian – Shqipëri.
- Raportimet periodike për përmbushjen e detyrimeve të Planeve Konkrete të Veprimit që Ministria e Brendshme ka hartuar dhe monitoruar zbatimin e tyre, për detyrat e dala nga takimet e nënkomitetit (JFS) dhe komitetit (KSA) si dhe Raport Progreseve të BE për Shqipërinë.
- Raportimet periodike të disa treguesve kryesore të punës së SHÇBA-së pranë Koordinatorit të Zyrës për Informacionin dhe Menaxhimin e Emergjencave Civile dhe Krizave (ZIMEK), në Ministrinë e Brendshme, në kuadër të raportimit të Ministrisë pranë Zyrës Operacionale të Situatës në Kryeministri.

❖ **Bashkëpunimi ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit**

Shërbimi ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione ligjzbatuese dhe shërbime inteligjente brenda vendit në përmbushje të misionit dhe objektit të veprimtarisë.

Rezultativ është konstatuar bashkëpunimi me DSIK, SHISH dhe Policinë e Shtetit. Në veçanti me DSIK bashkëpunimi është shtrirë në dy drejtime atë të procedurave verifikuese për pajisjen me CSP të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit dhe në funksion të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Bashkëpunim ka patur edhe me misionet partnere dhe projektet si ICITAP dhe PAMECA V, që asistojnë Ministrinë e Brendshme dhe strukturat e saj, kryesisht Policinë e Shtetit, por pa mënjanuar edhe Shërbimit tonë.

Për të ardhmen synohet shritja e bashkëpunimit me struktura homologe të Shërbimeve për Çështjet e Brendshme kryesisht me vendet e BE-se, për të njohur dhe përfituar nga arritjet e tyre në drejtim të organizimit, strukturave e standardeve të tjera.

¹¹ VKM nr. 246, datë 09.05.2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Europian 2018 – 2020”

III. Objektivat kryesore të punës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat për vitin 2019

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në zbatim të përmbushjes së angazhimit të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë për prioritetet e përcaktuara për anëtarësimin e Shqipërisë në BE; në kuadër të objektivave dhe masave konkrete për t'u realizuar që rrjedhin nga dokumentat strategjike ndërsektoriale si: Plani Kombëtar për Integrimin Europian, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit e Plani Respektiv i Veprimit; Planit Kombëtar i Veprimit Kundër Kanabisit 2018 – 2020; Dokumentit të Politikave Prioritare në Fushën e Rendit dhe Sigurisë të Ministrisë së Brendshme si dhe bazuar në vlerësimin e situatës aktuale, rezultateve dhe problematikave të konstatuara për vitin 2018, parashikon që për vitin 2019, si objektiva prioritare të veprimtarisë së tij, të jenë:

Objektivat:

- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe garantimin e pavarësisë operacionale të strukturave të Shërbimit, në përmbushje të misionit dhe objektit të veprimtarisë.
 - Përgatitjen e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.
 - Përgatitjen e paketës së akteve nënligjore me ndryshimet e nevojshme, që rrjedhin nga shtesat e ndryshimet që do t'i bëhen ligjit aktual të Shërbimit.
- Thellimi dhe përsosja e luftës kundër korrupsionit dhe çdo rasti të paligjshmërisë në rradhët e strukturave objekt i punës së Shërbimit, për të zbuluar, parandaluar dhe ndëshkuar në kohë çdo lloj forme të shfaqjes së saj, nëpërmjet:
 - Orientimit të strukturave të Shërbimit në njohjen sa më të mirë të situatës operative, në marrjen e një informacioni sa më cilësorë dhe orientimi i veprimtarisë informativo-gjurmuese jo vetëm ndaj strukturave të Policisë së Shtetit por edhe ndaj strukturave të Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin si dhe Gardës së Republikës.
 - Orientimit dhe drejtimit të punës informativo-gjurmuese, kryesisht në strukturat me rrisht të lartë korrupsioni si: strukturat e qarkullimit rrugor, strukturat e policisë kufitare, të krimit ekonomiko-financiar, të krimit të organizura (droga dhe trafiqet), të shërbimeve ndaj të tretëve etj.
- Fokusimi në rritjen e kapaciteteve hetimore për çështjet parësore dhe arritjen e rezultateve konkrete, me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve proaktive, referime të bazuara në të dhëna konkrete dhe të verifikueshme si dhe ndjekjen deri në fund të procesit të trajtimit të tyre nga prokuroria e gjykatat, në përmbushje të misionit dhe objektit të veprimtarisë së të Shërbimit, duke:

- Rritur kapacitetet profesionale të strukturave të hetimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve proaktive dhe paraprake deri në përfundimin dhe dërgimin e çështjes penale në gjykim.
 - Rritur kapacitetin hetimorë nëpërmjet forcimit të strukturës së hetimit (ndryshimet strukturore forcuan Drejtorinë e Hetimit me sektorë të rinj dhe me kapacitete njerëzore) dhe shfrytëzimit të instrumentave ligjorë që shërbejnë për përmbushjen e veprimtarisë hetimore si në aspektin procedural penal dhe në atë informativ – gjurmues.
 - Futjen e koncepteve të reja për analizimin e informacionit kriminal si dhe përdorimit dhe aplikimit të teknikave speciale të hetimit, gjurmimit e sekuestrimit të provave dhe aseteve që rrjedhin nga veprat penale, në bashkëpunim me Prokurorinë.
- Forcimi dhe rritja e kapaciteteve mbikqyrëse dhe kontrolluese ndaj strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, për zbatimin e ligjshmërisë, politikave dhe objektivave kryesore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
- Shërbimi do të kushtojë një rëndësi të veçantë kryerjes së inspektimeve me objekt konkret, duke dalë nga inspektimet rutinore apo panoramike, të fokusuara në problematika dhe fenomene evidente të dalë gjatë përmbushjes së veprimtarisë informativo - gjurmuese të Shërbimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe transparencës ndaj tij, në lidhje me veprimtarinë e Shërbimit:
- Intesifikimin e punës sensibilizuese të publikut për denoncimin e shkeljeve të ligjit nga punonjësit e strukturave, nëpërmjet fushatave sensibilizuese, pritjes, marrjes, trajtimit, analizimit dhe përgjigjeve në kohë dhe korrekte të çdo anese të shtetasve.
 - Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut nëpërmjet përmirësimit të veprimtarisë së inspektimit dhe trajtimit të ankesave në kohë dhe në mënyrë sa më cilësore.
 - Bërja publike e Raporteve të Inspektimit, treguesve dhe rezultateve të arritura nga hetimi administrativ i ankesave në mënyrë periodike.
- Monitorimin e vazhdueshëm të perceptimit të publikut për nivelin e sigurisë në komunitetin e tyre, sjelljes etike dhe profesionale të punonjësve të policisë, në veçanti të strukturave në kontakt me publikun si policia e rendit, policia kufitare apo jo rrugore etj., nëpërmjet kryerjes së:
- Sondazheve në publik, duke marrë kontakte direkte të punonjësve të Shërbimit në terren me qytetarë të ndryshëm, monitorimit të Zyrave të Pritjes së Publikut në

strukturat vendore të policisë si dhe nëpërmjet kontakteve dhe telefonatave që do të realizohen me ankues të ndryshëm.

- Vazhdimin e angazhimit të mëtejshëm të personelit dhe strukturave përkatëse të Shërbimit, për kryerjen e procedurave verifikuese për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit, në zbatim të detyrimeve dhe kërkesave të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Angazhimi maksimal në procesin e pritshëm të Vetting-ut të punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.
 - Këtij qëllimi i shërbeu edhe ndryshimi që ju bë strukturës së mëparshme duke e ngritur sektorin e mëparshëm në nivel drejtorie dhe forcuar me kapacitete njerëzore.
 - Plotësimi me personel të Drejtorisë së Verifikimit të Pastërtisë së Figurës & Monitorimit të Brendshëm dhe vënien në efikasitet të plotë të kësaj strukture.
- Realizimin e investimeve të planifikuara për përmirësimin me mjete mbështetëse dhe teknologji tekniko – shkencore, në funksion të rritjes së kapaciteteve të punës informative dhe hetimore të Shërbimit dhe përmirësimit të performancës së Shërbimit në të gjitha fushat e aktivitetit të tij, nëpërmjet:
 - Mbajtjes në gadishmëri dhe efikasitet të bazës logjistike të Shërbimit, si me mjete të ndërlidhjes, automjete, karburant, për strukturat e Shërbimit, në funksion të kryerjes së detyrave të ngarkuara.
 - Investimeve të reja në programe kompjuterike, teknike dhe mjete bashkëkohore për strukturat e Shërbimit, në interes të modernizimit të proceseve të punës, për përmbushjen me efikasitet dhe cilësi të detyrave funksionale.
- Motivimi i burimeve njerëzore ekzistuese të Shërbimit, rekrutimi i burimeve të reja dhe rritja e kapaciteteve profesionale të Shërbimit, nëpërmjet:
 - Trajnimeve në Akademinë e Sigurisë, e jo vetëm, në bashkëpunim të ngushtë me misionet këshillimore e monitoruese që asistojnë Ministrinë e Brendshme.
 - Motivimeve me rritjen në gradë të punonjësve që i plotësojnë kriteret dhe që spikasin me performancën e tyre,
 - Konkurimeve të hapura, për vende konkrete pune në Shërbim, me kërkesa specifike në përputhje me natyrën e vendit të punës.
- Vazhdimin e dixhitalizimit të të gjithë fondit të dokumentacionit që administrohet nga Sekretaria dhe Zyra e Kartotekës së Shërbimit, për përfundimin e plotë të të gjithë procesit.

SI MUND TË NA KONTAKTONI

Posta zyrtare – Drejtoria e Përgjithme e SHÇBA-së, Ministria e Brendshme, në adresën “Sheshi Skënderbe”, nr. 3, Tiranë;

Zyra e Ankesave, në godinën e Ministrisë së Brendshme, në adresën “Sheshi Skënderbe”, nr.3, Tiranë;

Zyrat e Drejtorisë/Sektorëve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, pranë Drejtorive të Policive në Qarqe;

Faqja e internetit të Shërbimit www.shcba.gov.al, me informacione mbi veprimtarinë e Shërbimit, njoftime e lajme.

Faqja e internetit të Shërbimit, rubrika “Ankesa”, ku mund të paraqitni një ankesë duke respektuar kërkesat e saj.

Posta elektronike, email: ankesa@shcba.gov.al;

Faqes së Zyrës së Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në rrjetin social Facebook

Linjës së gjelbër **0800 90 90**, linjës pa pagesë.

Zyra Qëndrore e Ankesave, shërben 6 ditë të javës nga ora 08:00 – 20:00 duke pritur qytetarët dhe marrë telefonatat nga publiku në linjën e gjelbër pa pagesë **0800 90 90**. Me anë të kësaj linje, punonjësi i zyrës komunikon drejtpërdrejtë me qytetarin, dhe sipas rastit e orienton atë për zgjidhjen e problemit.

Në këtë zyrë është instaluar dhe sistemi i elektronik i regjistrimit të telefonatave pas orës 20.00, i cili regjistron çdo telefonate. Ky sistem garanton transparencë dhe objektivitet duke mos patur mundësi ndërhyrje. Çdo telefonate e regjistruar zbardhet për t’u adresuar sipas problemeve të ngritura nga qytetarët.